

POLITIKAT ARSIMORE DHE LEGJISLACIONI

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Politikat arsimore dhe legjislacioni
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (semestri iparë)
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Fjolla Kacaniku
Detajet kontaktuese:	fjolla.kacaniku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kursi ka për qëllim të ndihmojë studentët të kuptojnë qartë konceptin e politikës arsimore, hartimin dhe zbatimin e tyre në praktikë. Në veçanti kursi do të shtjellojë kontekstin e politikave arsimore në nivel local, Evropian dhe global duke synuar një analizë kritike të tyre në lidhje me traditat e ndryshme të funksionimit të sistemeve arsimore duke analizuar ato krahas trendeve globale të reformës arsimore nën frymën neoliberale. Përvec kësaj, kursi do të vë në dukje për studentët ciklin e politikave, duke përfshirë një orientim praktik për hartimin e politikave, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. Në këtë kontekst do të shtjellohen dimensione praktike të perceptimit të politikave në nivel Kosove dhe do të shtjellohet procesi praktik i hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është që të përgatis studentët rreth të kuptuarit të politikave arsimore dhe aspektet e zbatimit të tyre në praktikë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit, studenti/jaduhet të jenë në gjendje të:</p> <p>Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● demonstrojë njohuri për tendencat e politikës arsimore në Kosovë dhe kontekste të zgjedhura ndërkombëtare ● demonstrojë të kuptuarit e zhvillimit të politikave arsimore, zbatimit dhe monitorimit të tyre ● identifikojë çështje të rëndësishme të politikave bashkëkohore në Kosovë dhe Evropë dhe diskutojë implikimet e tyre për shkollat, mësimdhënësit dhe nxënësit ● krahasojë pikëpamje të kundërta mbi politikat kryesore arsimore dhe dëshmitë e debatet që i rrethojnë ● analizojë mundësinë e përdorimit të politikave arsimore për zhvillimin e sistemeve të arsimit dhe kompleksitetin e tyre ● vlerësojë në mënyrë kritike zhvillimet e politikave të përzgjedhura për praktikën e shkollave dhe të mësimdhënësve

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokftime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	6	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	10	40
Përgaditja përfundimtare për provim	1	30	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2.5	5
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Kursi do të ofrohet nga një kombinim i leksioneve, seminareve, punës individuale të udhëhequr dhe prezantimeve të studentëve. Në realizimin e ligjëratave do të dominojë analiza dhe debati për të kuptuar implikimet e politikave arsimore në dimensione të ndryshme të sistemit të arsimit.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Studentët do të ballafaqohen me një variacion angazhimesh të cilat lidhen me rezultatet e pritura të kursit. Studentët do të vlerësohen përgjatë semestrit dhe do të kenë mundësi të marrin komente kthyes nga bartësit e lëndës për të përmirësuar punën e tyre në vazhdimësi. Në vijim ofrohet sqarim për vlerësimin e studentëve:</p> <p>Detyra 1: Op-ed/opinion, me mundësi të publikimit (15 %) Studentët do të shkruajnë një opinion (op-ed) për një temë të zgjedhur brenda sferës së politikave arsimore. Kjo detyrë synon të përmirësojë të kuptuarit e studentëve për kompleksitetet e qeverisjes së arsimit, të inkurajojë të menduarit kritik dhe të zhvillojë aftësinë e studentëve për të artikuluar opinione të informuara mbi çështjet e politikave.</p> <p>Detyra 2: Policy brief/ Analiza përmbledhëse e politikave arsimore (35 %) Studentët do të realizojnë një analizë përmbledhëse për një temë specifike të interesit të politikave publike në kontekstin e sistemit të arsimit. Në këtë punim, studentët duhet: 1) të demonstrojnë të kuptuarit e procesit të politikave arsimore, 2) të zbatojnë këtë njohuri për një çështje të caktuar politike, 3) të identifikojnë palët kryesore të interesit dhe institucionet e përfshira në diskutime në</p>		

	<p>lidhje me këtë çështje; 4) të diskutojnë se çfarë po bëhet aktualisht për të adresuar këtë çështje; dhe 5) të rekomandojnë një zgjidhje ose politika alternative (policy solutions).</p> <p>Detyra 3: Analiza e një politike arsimore/position paper (50 %)</p> <p>Qëllimi i kësaj detyre është të angazhojë studentët në një analizë gjithëpërfshirëse të një politike specifike arsimore që lidhet me interesat e tyre akademike dhe profesionale. Nga studentët pritet që të shqyrtojnë në mënyrë kritike politikën e zgjedhur, të artikulojnë një pozicion të mirëpërcaktuar mbi pikat e forta ose të dobëta të saj dhe të ofrojnë argumente të bazuara në dëshmi për të mbështetur qëndrimin e tyre. Detyra organizohet në pikat në vijim: (i) Identifikimi një politike arsimore, (ii) shqyrtimi i literaturës, (iii) përcaktimi i pozicionit, (iv) analiza e dëshmimeve, (v) adresimi i kundërargumenteve dhe (vi) rekomandimet.</p> <p>Udhëzimet për të gjitha detyrat do të publikohen në Google Classroom në fillim të semestrit.</p> <p>Notat: 55-60 = Nota 6 61-70 = Nota 7 71-80 = Nota 8 81 - 90 = Nota 9 91-100 = Nota 10</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Pakoja ligjore nga MASHT (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë)</p> <p>UNESCO (2011, 2012). World Year Book on Education (Policy Borrowing and Lending – 2012; Curriculum in Today’s World 2011). Paris: UNESCO.</p> <p>Mitchel, D., Crowson, R. & Shipps, D. (2013). Shaping education policy: Power and process. NeWYork: Routledge.</p> <p>Ball, S.J. (2011). Politics and Policy Making in Education: Explorations in Sociology. Routledge.</p> <p>Bowe, R., Ball, S.J., & Gold, A. (2017). Reforming Education and Changing Schools: Case studies in policy sociology.</p> <p>Steiner-Khamsi, G., Waldow, F. (2012). Policy Borrowing and Lending in Education. Routledge.</p> <p>Jones, B.M.A., & Ball, S.J. (2023). Neoliberalism and Education. Routledge.</p> <p>Abbott, I., Rathbone, M., & Whitehead, P. (2013). Education policy. SAGE Publications Ltd.</p> <p>Portnoi, P.L. (2016). Policy Borrowing and Reform in Education: Globalized Processes and Local Contexts. Palgrave Macmillan.</p>
Literatura shitesë:	Material shites i ofruar në formë të dispencës nga mësimdhënësi për temat e caktuara.

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje dhe prezantim i sillabusit
Java e dytë:	Përkufizime të politikës publike dhe kontekstit të politikave: Këndështrimi teorik dhe konteksti praktik
Java e tretë:	Sistemi i arsimit në Kosovë: Konteksti i politikave dhe akterët kryesor
Java e katërt:	Qëllimi prapa hartimit të politikave arsimore
Java e pestë:	Cikli i politikave: Planifikimi dhe hartimi
Java e gjashtë:	Cikli i politikave: Implementimi
Java e shtatë:	Cikli i politikave: monitorimi & vlerësimi
Java e tetë & nëntë:	Huazimi dhe transferi i politikave: Implikimet dhe limitet për kontekstin vendor
Java e dhjetë & njëmbëdhjetë:	Lidhja e politikave arsimore me zhvillimet teorike në arsim
Java e dymbëdhjetë:	Prezantim dhe diskutim i punës në grupe
Java e trembëdhjetë:	Prezantim dhe diskutim i punës në grupe
Java e katërbëdhjetë:	Prezantim dhe diskutim i punës në grupe
Java e pesëmbëdhjetë:	Reflekim & Përmbyllje

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> - Vijimi i rregullt i ligjëratave; - Ardhja me kohë dhe qëndrimi deri në fund; - Leximi i literaturës së kërkuar dhe artikujve të sugjeruar; - Pjesëmarrja në diskutime gjatë ligjëratave; - Përgatitja dhe dorëzimi i të gjitha detyrave në kohën e caktuar. Çdo vonesë do të ndëshkohet me pikë të humbura; - Nuk lejohet kopjimi dhe plagjiatura; - Vijimi dhe pjesëmarrja aktive është pjesë e integruar e detyrave.